

KARTELA E VLERËSIMIT PËR QASJE TË BARABARTË

Procese mbështetëse të politikave
për arritjen e të drejtave të njeriut
për ujë dhe sanitacion



Protokol për ujë dhe shëndet i Konventës për mbrojtjen
dhe shfrytëzimin e ujërave ndërkufitarë dhe
liqejve ndërkombëtarë

KARTELË VLERËSIMI PËR QASJE TË BARABARTË

procese mbështetëse të politikave
për arritjen e të drejtave të njeriut
për ujë dhe sanitacion

Protokol për ujë dhe shëndet i Konventës për mbrojtjen
dhe shfrytëzimin e ujërave ndërkufitarë dhe
liqejeve ndërkombëtarë





SQARIM

PËRSHKRIMET E PËRDORURA DHE PREZANTIMI I MATERIALIT NË KËTË PUBLIKIM NUK NËNKUPTON NDONJË SHPREHJE TË ÇFARËDO MENDIMEVE SI NGA ANA E SEKRETARIATIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË ASPEKT TË STTUSIT TË DREJTËSISË SË CILIT DO VEND, TERRITOR, QYTET OSE ZONË OSE TË ORGANEVE TË TYRE OSE NË ASPEKT TË KUFIJVE TË TYRE. SIMBOLET E DOKUMENTEVE TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËRBËHEN NGA SHKRONJA TË MËDHA TË KOMBINUARA ME FOTOGRAFI.

ECE/MP.WH/8

ISBN 978-9989-881-03-9

PARATHËNIE

Sigurimi i qasjes në ujë të sigurt për pije dhe sanitacion për tërë popullatën, pa diskriminim, paraqet obligim për të gjitha qeveritë. Të gjithë, qofshin të pasur ose të varfër, meshkuj ose femra dhe fëmijë, njerëzit që jetojnë në zona urbane dhe rurale, të cilët kanë ose jo strehim të përshtatshëm, njerëzit me të meta fizike ose njerëzit të cilët jetojnë në institucione si burgjet ose spitalet, kanë të drejtë të qasjes në këto shërbime.

Në vitin 2005, hyri në fuqi Protokoli për ujë dhe shëndet, duke i obliguar pjesëtarët e tij në regjionin Pan – European të sigurojnë “qasje të barabartë në ujë, të përshtatshëm si në kuantitet ashtu edhe në kualitet, të sigurohet për të gjithë pjesëtarët e popullatës, sidomos atyre që vuajnë për disavantazh ose përjashtim social”. Njohja e qasjes në ujë dhe sanitacion si e drejtë e njeriut nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të bashkuara dhe Këshilli i të drejtave njerëzore në vitin 2010, e cila fuqimisht u përkrah nga Franca, e vërtetoi obligimin e qeverive të sigurojnë se shërbimet për ujë dhe sanitacion janë në dispozicion, të arritshme, të sigurt, të pranueshme dhe mund ta përballojnë të gjithë, pa diskriminim. Qëllimet dhe iniciativat globale, siç janë qëllimet e zhvillimit mijëvjeçar dhe angazhimet e dhëna në Konferencën për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të bashkuara në vitin 2012 për sigurimin e realizimit progresiv të të drejtës së njeriut për ujë dhe sanitacion, si dhe opservimin e momentit të agjendës post – 2015 dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm në të ardhmen, përsëri e theksuan rëndësinë e koncentrimin të përpjekjeve tona dhe mjeteve financiare për implementimin e të drejtës së njeriut për ujë dhe sanitacion në praktikë. Përkrahja e vazhdueshme nga Franca e aktiviteteve për qasje të barabartë në kuadër të Protokolit për ujë dhe shëndet, e mundësoi përgatitjen e këtij publikimi, i cili ka për përkrahjen e proceseve të politikave për arritjen e të drejtave të njeriut për ujë dhe sanitacion. Rezultat kartela për qasje të barabartë e prezantuar në këtë publikim është kontribut për të mendësrit gjeneral për atë se si të implementohen në praktikë këto obligime dhe angazhimet. Përcaktimi i politikave dhe masave qëllimore për përmirësimin e gjendjes së qasjes në ujë dhe sanitacion kërkohet nga të gjithë njohje e detajuar e gjendjes aktuale, në kushte të instrumenteve të politikave, strategjive për finansim dhe programeve për masat që kontribuojnë për zvogëlimin e hendekut në qasje.

Kartela e rezultatit për qasje të njëjtë është mjet analitik për vetëvlerësim, i cili mund t’u ndihmojë qeverive dhe faktorëve tjerë që të vendoset baza, të diskutohet për aksionet e ardhshme. Ajo është krijuar nga rezultatet e publikimit paraprak *Askush nuk ka ngelë: praktika të mira për sigurim të qasjes së njëjtë në ujë dhe sanitacion, e cila ishte*

publikuar në mars të vitit 2012 në forumin e 6 – të për ujë në Marsej, Francë. Askush nuk është lënë l’identifikonte qasjet në resurset ujore, hendekun urbano - rural, qasjen për grupet e rrezikuara dhe të marginalizuara dhe pranueshmërinë si sfida kontekstuale kryesore duke i futur në kornizë pabarazitë aktuale në regjionin Pan – European. Kartela e vlerësimit për qasje të njëjtë thërret për informatë për opsionet politike të cilat mund të zgjidhen nga vendet që të tejkalohen këto sfida të ndryshme.

Ne duhet patjetër t’i inkurajojmë vendet që të angazhohen në mënyrë vullnetare në këtë proces të vetë vlerësimit, i cili mund të sigurojë analize të gjendjes për barabarësi në qasje. Ky ushtrim vërtetoi se sjell shumë përfitime gjatë pilot fazes së saj, për shembull në qytetin e Parisit ku ishte kryer ushtrimi për vetëvlerësim dhe ishin fituar informata të vlefshme për formulimin e planeve të reja nacionale dhe regjionale për shëndet dhe mjedis jetësor, sidomos për dimensionet e saj të barabarësisë. Për shkak se ushtrimi përfshin spektër të gjërë të faktorëve nga sektori ekologjik deri te ai social dhe financiar, ai ndihmon që të identifikohen partnerët e vërtetë dhe të inicohet bashkëpunim për marrjen e aktiviteteve të ardhshme. Më tej, rezultatet nga vetë vlerësimi mund të shfrytëzohen që të ndihmohet përcaktimi i qëllimit i cili është i lidhur me barabarësinë në kuadër të Protokolit, si dhe masa përkatëse, të bazuara në vlerësimin detal të hendeqeve të cilët duhet të tejkalohen. ë

Unë besoj se ky publikim do t’i stimulojë vendet që të shfrytëzojnë kartelën e poenave për qasje të njëjtë dhe ta përkrahin realizimin progresiv të të drejtës së njeriut për ujë dhe sanitacion përmes përkrahjes në inkluzimin e dimensioneve për qasje të njëjtë në proceset politike aktuale.

Marisol Turen

Z-nja Marisol Turen

Ministër për punë sociale dhe shëndetës
Francë



FALËNDERIM

Ky publikim është përgatitur në kornizat e Komisionit ekonomik të Kombeve të Bashkuar për Europë (UNECE) /Organizata botërore e shëndetësisë, Zyra regjionale për Europë (OBSh/Europë). Kjo nuk do të ishte e mundur pa përkrahjen nga shumë qeveri, individë dhe organizata ndërkombëtare si dhe organizatave jo qeveritare.

Si sekretariat i përbashkët, do të donim posaçërisht të falënderojmë anëtarët e grupeve proektuese nga vendet të cilat pilotuan kartelën e poenave:

Ukrahinë: Irina Rudenko, Servisi shtetëror Sanitar dhe Epidemiologjik; Irina Bajsaroviç, Taras Shevçenko, Universiteti Nacional i Kievit dhe Ana Cvetkova, NGO MAMA-86

Franca (Zona më e madhe urbane e Parisit):

Delfin Kamano, Ministria për punë sociale dhe shëndetësi; Silien Rotilon dhe Odil Nieviaer, Meri nga Parisi.

Portugalia: David Alvesh dhe Alvaro Karvalo, Servisi Entiteti regulator i Aguas dhe Reziduos (ERSAR).

Gjithashtu jemi shumë falënderues ekspertëve lokal të cilët kontribuan në pilot ushtrimet përmes sigurimit të të dhënave dhe komentëve.

Në zhvillimin e kësaj vegle na kanë ndihmuar shumë komentet, idetë dhe inspirimi i anëtarëve plotësues nga grupet e ekspertëve në progresin monitorues në arritjen e qasjes së njëjtë në ujë dhe sanitacion:

Serik Ahmetov, Ministria për mbrojtjen e mjedisit jetësor, Kazakistan

Armin Arushanian, Ministria për mbrojtjen e natyrës, Armeni

Alena Drazdova, Ministria për shëndet publik, Belarus

Fabien Dupui, Ministria për punë të jashtme, Francë

Dag Hongve, Institut për shëndet publik, Norvegji
Tanja Knezheviç; Instituti për shëndet publik, Sërbi

Ingeborg Limburg, Agjencioni Flamang për mjedis jetësor, Belgjikë

Janik Pavago, Ministria për punë sociale dhe shëndetësi, Francë

Pjer Studer, Zyra federale për shëndet publik, Zvicër

Didier Aleli, Organizata botërore e shëndetit

Ema Anakhasian, HBO – Gratë ermine për shëndet dhe mjedis jetësor të shëndetshëm

Gala Bardarska, Partneritet global për ujë për Europën Qendrore dhe Lindore (GWPCEE)

Helen Busard, Legjislatura për ujë (WaterLex)

Madoka Saxhi, Zyra e Komisarit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejta të njeriut

Anri Smets, academia franceze për ujë

Klaudia Vendland, Gratë në Europë për të ardhme të përbashkët (WEFCF)

Oliver Shmol dhe Enksetseg Shine, sekretariati i përbashkët, OBSh/ Europë

Françeska Bernardini, anëtar I mëhershëm I sekretariatit të përbashkët, UNECE

Nikolas Bonvoazin dhe Shantal Demilkaps, sekretariati i përbashkët, UNECE

Komente plotësuese janë siguruar nga: Marta Varga, Hungari; Xhuli Perkins, UN-Habitat; Karen Amlaev, OBSh rrjeti i qyteteve të shëndetshëm, Ksavier Metrerobert, Aquafed.

Nga OHEKE, Kamil Marselo dhe Katri Veldre siguruan përkrahje administrative të procesit. Nade\da Kamrakulova, Alisher Mamaxhanov dhe Volodimir Kevalo kontribuan në finalizimin e publikimit. Publikimimi u redaktua nga Kristina O'Shonesi. Roberto Martin-Hurtado, UNECE Konsultant, ishte autor kryesor i dokumentit.

Sekretariati i përbashkët falënderohet për finansim të siguruar nga Ministria franceze për punë sociale dhe shëndetësi.





PËRMBAJTJA

PARATHËNIA	iii
FALËNDERIM	v
LISTA E AKRONIMEVE DHE TERMAVE TË RËNDËSISHME	viii
HYRJE	1
Kapitulli 1 QASJE E BARABARTË NË UJË DHE SANITACION	5
Sfidat	5
Obligimet ndërkombëtare	6
Strukturat drejtuese të autoriteteve	6
Zvogëlimi i dallimeve gjeografike	6
Sigurimi i qasjes për grupet e rrezikuara dhe të margjinalizuara	7
Të mundësuarit e qasjes në ujë dhe sanitacion për të gjithë	7
Kapitulli 2 SI TË PËRDORËT KARTELA E VLERËSIMIT	9
Si të organizohet ushtrimi për vetë vlerësim dhe interpretim të rezultateve	9
Udhëzime praktike – Shënime për plotësimin e kartelës së poenave	12
Fjalor i termeve themelore	13
Kapitulli 3 PËRVOJAT E VENDEVE NË PËRDORIMIN E KARTELËS SË POENAVE	17
Franca (zona më e madhe urbane e Parisit)	17
Portugalia	18
Ukrahina	19
Kapitulli 4 KARTELA E VLERËSIMIT	21
Profil i vendit / regjionit	22
Të dhëna socio-ekonomike dhe sektoriale	22
Obligimet ndërkombëtare për ujë dhe sanitacion	22
Pjesa 1 KORNIZAT E AUTORITETEVE UDHËHEQËSE PËR MUNDËSIMIN E QASJES NË UJË TË SIGURT PËR PIJE DHE NË SANITACION	23
Fusha 1.1 Korniza strategjike për të arritur qasje të barabartë	23
Fusha 1.2 Sektori për politikë financiare	24
Fusha 1.3 Të drejtat dhe detyrat e shfrytëzuesve dhe bartësve tjerë të drejtave	26
Pjesa 2 ZVOGËLIMI I DALLIMEVE GJEOGRAFIKE	27
Informata kuantitative për dallimet gjeografike	27
Fusha 2.1 Politika publike për zvogëlimin e dallimeve në qasje mes zonave gjeografike	28
Fusha 2.2 Politika publike për zvogëlimin e dallimeve në çmime mes zonave gjeografike	29
Fusha 2.3 Shpërndarja gjeografike e përkrahjes nga jashtë për sektorin	30
Pjesa 3 SIGURIMI I QASJES PËR GRUPET E RREZIKUARA DHE TË MARGJINALIZUARA	31
Informata kuantitative për grupet e rrezikuara dhe të margjinalizuara	32
Fusha 3.1 Politika publike që u përgjigjen nevojave të grupeve të rrezikuara dhe të margjinalizuara	33
Fusha 3.2 Persona me nevoja të posaçme fizike	34
Fusha 3.3 Shfrytëzuesit e institucioneve shëndetësore	35
Fusha 3.4 Shfrytëzuesit e institucioneve arsimore	36
Fusha 3.5 Shfrytëzuesit e shtëpive të pleqve	37
Fusha 3.6 Të burgosurit	38
Fusha 3.7 Refugjatë të cilët jetojnë në kampe dhe qendra për refugjatë	39
Fusha 3.8 Persona të pastrehë	41
Fusha 3.9 Udhëtarë dhe komunitete nomade	42
Fusha 3.10 Persona që jetojnë në shtëpi pa ujë dhe sanitacion	43
Fusha 3.11 Persona pa qasje në ujë të sigurt për pije dhe në sanitacion në vendet e tyre të punës	44
Kapitulli 4 MUNNËSIMI I QASJES TË TË GJITHËVE NË UJË DHE SANITACION	45
Informata kuantitative për qasjen	45
Fusha 4.1 Politika publike për sigurimin e qasjes	46
Fusha 4.2 Masa tarifore	47
Fusha 4.3 Masa sociale për mbrojtje	48
KONTROLLIM I REZULTATEVE	49

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

SHQ	Shoqata qytetare
ERSAR	Agjencioni regullator për shërbime të ujit dhe mbeturinave (Entidade Reguladora dos Serviços de Águas e Resíduos)
BE	Bashkësia Europiane
BPV	Bruto prodhimi vendor
OJQ	Organizata joqeveritare
SEDIF	Sindikata për ujërat nga d'Île-de-France (Syndicat des Eaux d'Île-de-France)..
SIAAP	Sindikata ndërsektoriale për sanitacion të aglomeracionit të Parisit (Syndicat Interdépartemental pour l'Assainissement de l'Agglomération Parisienne
SSES	Shërbimi shtetëror sanitary dhe epidemiologjik i Ukrainës (State Sanitary and Epidemiological Service of Ukraine)
UNECE	Komisioni Ekonomik për Europën pranë Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për fëmijë pranë Kombeve të Bashkuara
WASH	Ujë, sanitacion dhe higjienë
WHO / OBSH	World Health Organization / Organizata Botërore e shëndetësisë
OBSH/ Europë	Zyra regjionale e OBSH –së për Europë

HYRJE

Qasja në ujë të sigurt për pije dhe në sanitacion është e drejtë njerëzore, e cila është pjesë e të drejtës për standard të përshtatshëm të jetesës, të përfshirë në nenin 11 të Paktit ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Ai qartë është i pranuar nga ana e Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Prandaj anëtarët janë ligjërisht të obliguar të sigurojnë qasje në ujë dhe sanitacion për të gjithë dhe duhet të marrin hapa drejt realizimit të plotë të kësaj të drejte. Për të pëmbushur këtë obligim, ata duhet të sigurojnë se qasja në ujë dhe sanitacion është i barabartë për tërë popullatën.

Disa njerëz kërkojnë vëmendje të veçantë. Për shembull, njerëzit të cilët jetojnë bashkësi të vogla rurale, personat e pastrehë ose të varfërit që jetojnë në qytete dhe nuk mund ti paguajnë faturat e ujit. Nëse nuk i kushtohet vëmendje e veçantë zgjidhjeve të cilat fokusohen te këta njerëz të cilët është vështirë të përfshihen, dallimet në qasje në ujë dhe sanitacion sigurisht do të rriten dhe do të dështojnë përpjekjet tona.

Është e vështirë të besohet se në regjionin Pan – European në vitin 2011, 19 milion njerëz nuk kanë patur qasje në burim të rregulluar të ujit për pije dhe 67 milion njerëz nuk kanë patur qasje në sanitacion të përmirësuar, gjë që rezultoi me raste të vdekjeve shumë të hershme secilin vit. Ne gjenim dallime të dukshme, jo vetëm në mes vendeve, por edhe përbrenda një vendi, dhe këto dallime nuk ishin të rastit. Për shembull, në një vend, 40% e popullates që ishte më e varfër, ka 7 herë më pak mundësi të qasjes se sa të pasurit që përbënin 20%. Qasja në ujë dhe sanitacion mbetet sfida në regjionin Pan - European, me grupe specifike të popullates e cila përballet me pengesa reale në të gjitha vendet.

Angazhimet ligjore dhe politike kërkojnë ti adresojmë pabarabarësitë në qasje të ujit dhe sanitacionit. Për shembull, palët e UNECE - OBSH/Protokoli për ujë dhe shëndet e angazhuan veten për të siguruar qasje të barabartë në ujë të sigurt për pije dhe sanitacion përkatës përmes ratifikimit të Protokolit. Në vitin 2010 Deklarata e Parmës për mjedis jetësor dhe shëndet shtroi çështjen për fëmijët, si grup i rrezikuar

Regjioni Pan – European do ti „sigurojë çdo fëmije qasje në ujë dhe sanitacion nëpër shtëpitë, qendrat e kujdesit për fëmijë, çerdhet, shkollat, institucionet shëndetësore dhe ujërat publike rekreative deri në vitin 2020“

Edhe vedet e regjionit Pan – European, të cilat veprojnë në kuadër të Protokolit për ujë dhe shëndet, përballohen me sfida. Në vitin 2012, grupi punues për ujë dhe shëndet e botoi publikimin „*Askush nuk është lënë anash: praktika të mira për sigurimin e qasjes së barabartë në ujë dhe sanitacion në regjionin Pan - European*“.

Duke vënë në dukje opsionet politike dhe praktikat e mira, publikimi identifikon tri sfida kyçe në aspekt të qasjes së barabartë:

- Zvogëlimin e dallimeve në shërbimet të cilat i siguron;
- Pengimin e diskriminimit ose përjashtimit në qasje të shërbimeve për grupet e rrezikuara dhe të marginalizuara
- Të sigurohet qasje financiare nga ana e shfrytëzuesve.

Publikimi, gjithashtu sugjeron se lidhje e fortë mes sigurimit të furnizimit me ujë dhe sanitacionit kërkon qasje politike. Porosia e saj e përgjithshme është se ne kemi në dispozicion mjete të politikave dhe përvojë në shfrytëzimin e tyre që të sigurohet se ne mund të bëjmë përparim të fuqishëm drejt qasjes univerzale në ujë dhe sanitacion.

Dokumenti aktual paraqet mjet analitik i cili mund tu ndihmojë autoriteteve dhe palëve tjera të interesuara për të krijuar një pikënisje, të bisedojnë për aktivitete të mëtutjeshme të cilat duhet të ndërmerren dhe evaluimin e e përparimit perms

procesit të vetë vlerësimit. Ai, gjithashtu ofron drejtime për atë se si duhet të shfrytëzohet mjeti analitik, në bazë të përvojës nga tri pilot aktivitetete të kryera në Francë, Portugali dhe Ukrainë.

Mjeti është në formë të kartelës së vlerësimit. Ajo është një listë e opsioneve politike, dhe shfrytëzuesi pritet të sigurojë dhe ta arsyetojë rezultatin i cili e përmbledh shkallën deri në të cilën shfrytëzohet numri i madh i opsioneve politike. Kartela e vlerësimit, gjithashtu, kërkon të dhëna kuantitative që ti kontestojë rezultatet dhe e përshkruan nivelin e qasjes në ujë të sigurt për pije dhe në sanitacion. Si shfrytëzues të kartelës së vlerësimit, duhet të ndiheni të lirë në mënyrë që ta përshtatni për nevojat tuaja personale.

Kartela e vlerësimit mund të shfrytëzohet nga ana e çdo vendi, regjioni, ose qyteti të botës që të realizohet vetëvlerësimi. Ajo është e dizajnuar, jo për të bërë një krahasim në mes vendeve (ose territoreve më të vogla brenda një vendi), por që t'ji mundësohet vendit (ose territoreve më të vogla brenda një vendi) të krahasohen rezultatet e ndryshme personale me kalimin e kohës.

Edhe pse kartela e vlerësimit nuk është pjesë e raporteve zyrtare në përputhshmëri me Protokolin për ujë dhe shëndet, palët e Protokolit janë shumë të inkurajara që ta shfrytëzojnë atë, në mënyrë që të fitojnë bazën e analizës për qasje të barabartë në ujë dhe sanitacion, për të identifikuar lidshmërinë e prioriteteve, të vihen qëllimet për tejkalimin e manësive të identifikuara dhe të vlerësohet përparimi.

Arritja dhe ruajtja e qasjes së barabartë varet nga funksionimi i mire i sektorit për ujë dhe sanitacion. Kartela e vlerësimit nuk fokusohet në funksionimin gjeneral të sektorit për ujë dhe sanitacion. Dhe, nuk trajton rrethanat tjera të cilat mund të kenë ndikim në qasje të barabartë në ujë dhe sanitacion, siç është udhëheqja me resurset ujore. Kartela e vlerësimit fokusohet në pyetje të zgjedhura dhe indikatorë të cilët së bashku mund të sigurojnë pasqyrë solide të gjendjes së qasjes në ujë dhe sanitacion në aspekt të barabartësisë në kohë të ndryshme.

Procesi i vetëvlerësimi t, siç është paraqitur nga përvoja e Francës (zona më e madhe urbane e Parisit), Portugalisë dhe Ukrainës, mundet tu mundësojë autoriteteve të identifikojnë partnerë të përshtatshëm që do të marrin punë plotësuese, të ndihmojnë në iniciimin e bashkëpunimit mes autoriteteve dhe palëve tjera të interesuara, dhe mund të gjenerojë kontribut në proceset e krijimit të politikave. Me pjesëmarrjen e një spektri të gjërë të palëve të interesuara, vetë vlerësimi mund ta ngrejë vetëdijen dhe të mundësojë të kuptuarit e përbashkët të qasjes së barabartë në ujë dhe sanitacion, si dhe të menduarit kreativ.

Përdorimi i kartelës së vlerësimit mund të ndihmojë në paraqitjen e qasjes të bazuar në dëshmi dhe qasje strukturale të diskutimeve në mes palëve të interesuara. Kjo mund të mundësojë zhvillim të „rezolucionit të lartë“ të analizës së situatës (duke përfshirë identifikimin e politikave ekzistuese dhe aktivitetet aktuale, dhe të tregojë mangësitë në mes legjislacionit dhe realitetit në teren) të cilat mund të hapin debat objektiv. Kartela e vlerësimit, gjithashtu, mund të ndihmojë që të zgjerohet fusha e bisedimeve dhe të qartësohet nevoja për përmirësimin e disponueshmërisë së informatave dhe konfidencialiteti.

Pjesa e mbetur e dokumentit është e strukturuar nga 4 pjesë. Pjesa 2 shkurtimisht diskuton për sfidat, dimensionet dhe aktivitetet e nevojshme që të sigurohet qasje e barabartë në ujë dhe sanitacion. Pjesa 3 siguron drejtime për atë se si të përdoret kartela e vlerësimit dhe kahjet strategjike për atë se si të organizohet ushtrim për vetë vlerësim, si dhe orientim praktik për atë se si të plotësohet kartela e vlerësimit. Pjesa 4 i prezanton përvojat e Francës (zona më e madhe urbane e Parisit), Portugalisë dhe Ukrainës në shfrytëzimin e kartelës së vlerësimit. Pjesa 5 e paraqet vetë mjetin.





Kapitulli 1

QASJE E BARABARTË NË UJË DHE SANITACION

SFIDA

Pa barazitë e tashme në qasjen në ujë të sigurt për pije dhe në sanitacion adekuat kërkojnë qasje specifike. Një personi mund t'i mungojë qasje në ujë të sigurt për pije dhe në sanitacion, thjesht për shkak se nuk ka qasje në ujë të sigurt dhe në sanitacion për tërë komunitetin ose për shkak të degradimit të resurseve ujore (mungesë, ndotje), por më shpesh i takon udhëheqjes së dobët ose asnjëfarë udhëheqjeje me infrastrukturë ujore dhe sanitare. Ose, personi mund të ketë qasje, por nuk ka mundësi të bëjë pagesën e faturës për ujë dhe sanitacion pa u zvogëluar harxhimi i gjërave tjera themelore dhe shërbimeve.

Komuniteti mund të ketë qasje në ujë të sigurt për pije dhe në sanitacion, por ato shërbime a) nuk i janë adaptuar grupeve të caktuara me nevoja të veçanta (p.sh. persona me nevoja të posaçme), (b) Nuk janë në mënyrë adekuate në dispozicion të institucioneve në të cilat mbështeten ato grupe (p.sh. shkollat, burgjet, kampet e rrefugjatëve) ose (c) grupe të caktuara (p.sh. pakicat etnike, imigrantët jolegal) mund të mohohet qasja në ujë dhe sanitacion për shkak të praktikave diskriminatore me ose pa qëllim.

Në regjionin Pan – European, katër sfida kontekstuale i formojnë mos barazitë në qasje:

- **Disponueshmëria në resurset ujore.** Degradim të kualitetit të resurseve ujore do të thotë se shumë qytete dhe fshatra të cilat mbështeten në burimet lokale të ujit nuk kanë qasje në ujë të sigurt, gjersa mungesa e ujit mund t'i privojë disa qytete dhe fshatra nga qasja. Ujërat e ndotur që të bëhen të përshtatshëm për pije duhet të trajtohen dhe ujërat e ëmbla mund të sillen nga distanca të mëdha, por këto zgjidhje teknike kërkojnë harxhime të mëdha.
- **Hendeku qytet – fshat dhe disponueshmëria e infrastrukturës për furnizim me ujë dhe sanitacion.** Zonat rurale në regjionin Pan – European kanë nivel dukshëm më të ulët të qasjes në ujë dhe sanitacion në krahasim me meset urbane.
- **Barierat specifike me të cilat përballen grupet e rrezikuara dhe të marginalizuara.** Njerëzit të cilët u takojnë këtyre grupeve nuk kanë qasje të barabartë në ujë dhe sanitacion si pjesa tjetër e shoqërisë. Situata ndryshon varësisht nga grupi, si për shembull: (a) personat me nevoja të posaçme fizike (si ç'janë personat e hendikepuar ose personat e sëmurë); (b) personat të cilët mbështeten në objekte publike (për shembull udhëtarë dhe persona të pastrehë); (c) persona të cilët i shfrytëzojnë objektet për furnizim me ujë nga institucionet, si ç'janë spitalet, shkollat, burgjet dhe kampet e refugjatëve ose (d) persona të cilët jetojnë në shtëpi jo higjienike.

- **Përballueshmëria.** Është një shqetësim në rritje për të gjitha vendet. Për vendet më të varfëra, ose pjesa më e madhe e populates ndajnë një pjesë bukur të madhe të të ardhurave të tyre për të shlyer faturat për ujë dhe shërbime sanitare, ose në fund ata do të përballen me situatë në të cilën tarifat mund të rriten në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria financiare. Në vendet e BE -së, qëllime më të rrepta për kualitet të ujit dhe përparim drejt mbulimit të plotë të harxhimeve, gjithashtu, do të thotë se pagesa e ujit dhe shërbimeve sanitare bëhet shqetësim i vërtetë për familjet me të ardhura të ulëta.

DETYRIMET NDËRKOMBËTARE

E drejta e njeriut për ujë dhe sanitacion i jep të drejtë secilit për ujë dhe sanitacion që është në dispozicion, e arritshme, e përballueshme dhe e sigurtë (Komiteti për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore, Komenti I përgjithshëm 15 (E/C.12/2002/ 11), Rezoluta e Asamblesë së përgjithshme 64/292, Rezoluta e Këshillit për të drejtat e njeriut A/HRC/RES/15/9). Disa komponenta të të drejtës në ujë dhe sanitacion mendohet se janë punë të realizimit progresiv, por obligimet si ç'janë mos diskriminimi janë obligime të menjëhershme. Prej këtu, mund të sillen masa pozitive të diskriminimit që të sigurohet qasje për të gjithë, para se të përmirësohen kushtet për qasje të atyre që veç më i gëzojnë këto të mira.

Sipas Protokolit për ujë dhe shëndet, palët duhet të sigurojnë qasje në ujë dhe sanitacion për të gjithë. Si dhe komponentat tjera të të drejtës njerëzore për ujë, si ç'janë qasja në informata, pjesëmarrja e publikut dhe masat e llogari dhënies, Protokoli në mënyrë speciale i obligon palët e tij për promovimin e qasjes së barabartë në ujë dhe sanitacion, për të gjithë pjesëtarët e popullatës, sidomos të atyre që vuajnë nga mungesa ose përjashtimi social". Protokoli siguron kornizë të forte për kthimin në praktikë të të drejtës së njeriut për ujë dhe sanitacion, sidomos përmes vënies së qëllimeve konkrete dhe datave të arritjes së qëllimeve, të përshtatura sipas situatës dhe kapaciteteve të vendit.

Shtetet duhet t'i shfrytëzojnë në maksimum resurset e disponueshme për realizimin e plotë të të drejtës për ujë dhe sanitacion. Njëkohësisht, si në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e Protokolit, bashkësia ndërkombëtare e njeh obligimin ligjor për ndihmë dhe bashkëpunim. Edhe pse resurse të dukshme financiare nga ana e bashkësisë ndërkombëtare i janë përkushtuar përmirësimit të qasjes në ujë dhe sanitacion, edhe më tutje ekziston nevoja që këto contribute të rriten.

KORNIZAT E UDHËHEQJES ADMINISTRATIVE

Realizimi i të drejtës për ujë dhe sanitacion kërkon angazhim politik dhe vizion afatgjatë. Kornizat aktuale nacionale dhe lokale të udhëheqjes me ujin ndonjëherë nuk kanë sukses të sigurojnë qasje të barabartë, për shkak të arsyeve në vijim: (a) kornizat më të gjëra të udhëheqjes mund ta kufizojnë ose t'i minimizojnë përpjekjet në sektorin për ujë; (b) udhëheqja e dobët me ujë rezulton me punë të keqe të sektorit; dhe (c) kornizat e tashme të udhëheqjes me ujin shpesh janë „të verbëra në barabarësi“.

Mirëpo, udhëheqja e mirë dhe menaxhimi me ujërat mund të kalojë rrugë të gjatë deri te arritja e qëllimit për qasje të barabartë. Shembujt përfshijnë qasje transparente deri te informatat, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara në procesin e vendimit, stimulime për operatorët që të përmirësojnë efikasitetin dhe të ulin harxhimet si dhe mekanizmat për përgjegjësi dhe kompenzim të dëmeve të jenë në dispozicion të të gjith njerëzve

Kjo me siguri nuk do të jetë e mjaftueshme. Aplikimi i „lente për qasje të barabartë“ do ta përshpejtojë përparimin. Kjo kërkon plan aksionar të orientuar drejt rezultateve, ngritjen e analizave të situatës së vendit dhe indikatorë kontekstual – specifik të specifikitetit.

Të gjitha palët e interesuara për ujë dhe sanitacion duhet të angazhohen dhe rolet dhe përgjegjësitë të identifikohen dhe të ndahen. Shfrytëzuesit e ujit patjetër duhet të marrin pjesë aktive, e jo vetëm si shfrytëzues. Transparencë, qasje në informata, edukim dhe mekanizma të pjesëmarrjes duhet të institucionalizohen që të sigurohen rezultate të barabarta dhe të qëndrueshme. Pjesëmarrja e pjesëtarëve të grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara, paraqet sfida të vërtetë për të gjitha vendet dhe duhet tu kushtohet vëmendje e posaçme. Operatorët me ujë duhet të jenë më shumë përgjegjës për sigurimin e qasjes së barabartë, e qeveria dhe organizatat shoqërore qytetare duhet të luajnë rol më të madh.

ZVOGËLIMI I DALLIMEVE GJEOGRAFIKE

Edhe në kornizat e një vendi, furnizimi me ujë në zona të ndryshme gjeografike mund të jetë tepër e ndryshme. Sipas Programit të përbashkët monitorues të Fondit të fëmijëve pranë Kombeve të bashkuara (UNICEF) dhe Organizatës botërore të shëndetësisë (OBSH), në vitin 2011, qasja në zgjidhje më të mira për ujë dhe sanitacion në zonat rurale në regjionin Pan – european është më e ulët se në mjediset urbane. Për shembull, në Kaukaz dhe Azinë Qendrore, 96% e popullatës e cila jeton në mjediset urbane ka qasje në burime të përmirësuara të ujit në krahasim me 79% në zonat rurale. Përkrah kësaj, në regjionin e OBSH/Europë, 96% nga anvisëritë urbane kanë qasje në rrjetin e ujësllësit gjer në shtëpi përkundër 72% të amvisërive rurale. Kjo mund të jetë rezultat jo vetëm i strukturave themelore të shpenzimeve, por njëkohësisht, edhe i ndikimeve dhe vendimeve politike.

Zvogëlimi i hendekut në qasje kërkon përpjekje politike, financiare dhe teknike. Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të luajë rol të rëndësishëm në eliminimin e këtyre mungesave, duke e fokusuar përkrahjen në zonat të cilat secili shtet i ka identifikuar

si të ngelura pas. Më me rëndësi, dallimet gjeografike në qasje nuk janë vetëm çështje të politikës për ujë, por edhe të politikës regjionale.

Politika publike ka rol fundamental në uljen e disparitetit të çmimeve mes zonave gjeografike, përmes: (a) tagretimit të programeve investuese dhe subvencioneve për zonat me çmime më të larta të shërbimeve, (b), mundësimin të subvencionimit të kryqëzuar nga zona me të ardhura më të larta dhe çmime më të ulëta kah zonat me të ardhura të ulëta dhe çmime më të larta dhe (c) promovimit të efikasitetit dhe çmimeve përmes reformës në organizimin sektorial dhe përdorimit të mjeteve të informimit si ç'janë vlerat referente tarifore dhe ato standarde.

SIGURIMI I QASJES PËR GRUPET E RREZIKUARA DHE TË MARGJINALIZUARA

Principet e të drejtave të njeriut e theksojnë nevojën për dizajnim aktiv të politikave për ujë dhe sanitacion, të cilat prioritet i japin dhe adresohen për nevojat e grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara. Uji dhe sanitacioni i këtyre grupeve është pyetje e shpeshtë e përjashtimit social, e jo vetëm çështje e ujit.

Çdonjëra prej këtyre grupeve ka nevoja të veta dhe përballet me lloj-lloj barriera për të arritur deri qasja e barabartë. Këto grupe dhe politikave dhe zbatuesit duhet të gjejnë kohë dhe resurse që t'i identifikojnë këto grupe, të analizohet a janë ato të kësaj, dhe të sigurohet se nevojat e tyre janë marrë parasysh. Në shumë raste, zgjidhjet adekuate kërkojnë përgjigje të integruar, me kombinimin e politikave dhe sigurimin e bashkëpunimit të institucioneve publike. Zgjidhjet, gjithashtu, kërkojnë resurse financiare të targetuara, por ato shumë rrallë janë të mëdha në krahasim me buxhetin e shtetit për ujë dhe sanitacion. Zgjidhjet në pjesën më të madhe kërkojnë rritje të ndërgjegjes dhe fokus specifik në mesin e kreatorëve të politikave dhe personelit teknik.

RUAJTJA E UJIT DHE SANITACIONIT TË PËRBALLUESHËM PËR TË GJITHË

Në shtetet e Europës Perëndimore, rritja e shpenzimeve për ujë dhe sanitacion (i përket para së gjithash kërkesave më të mëdha për trajtim të ujrave të ndotur) ka qenë dhe do të vazhdojë të reflektohet në faturat e ujit dhe sanitacionit. Në vendet e Europës Lindore, ku çmimet e ujit kanë qenë tradicionalisht të ulëta, fatura e ujit, me siguri, do të rritet. Qasja është brengë e shpeshtë dhe në rritje të vazhdueshme në regjionin pan – Europian, dhe kërkohet adoptim i strategjisë afatgjate në çdo vend. Përndryshe, problem i madh shëndetësor do të mund të paraqitet, duke u nisur nga konfrontimi i njerëzve për çmimin e lartë të ujit ata mund të orientohen kah alternativat më pak të shtrenjta, por më pak të sigurta, si ç'janë pusët private me ujë nëntokësor me kualitet të dyshimtë të ujit.

Brengat për qasjen nuk janë të lidhura vetëm me nivelet e tarifave, por në të vërtetë udhëhiqen nga pesë grupe të variablave në një vend apo zonë të caktuar:

- niveli i të ardhurave dhe shpërndarja e tyre;
- shpenzimet për sigurim në qasje në vend ose zone të caktuar;
- politika të subvencioneve;
- politika të themeluara tarifore;
- sjellja individuale e shfrytëzuesve në aspekt të shpenzimit të ujit.

Përputhshmëria me indikatorët nacional të qasjes nuk është e mjaftueshme për të siguruar se grupet e njerëzve me të ardhura të ulëta në çdo vend kanë qasje të pranueshme; duhet të zhvillohen politika specifike. Disponueshmëria e ujit është diçka më shumë se vetëm çështje e ujit, ajo është çështje e mbrojtjes sociale e cila kërkon përfshirje të aspekteve të ujit dhe sanitacionit në diskutimet e politikës sociale.

Ekzistojnë shumë opsione politike të cilat mirren me problemet e qasjes, edhe në tarifën por edhe jashtë tyre. Kriteret e zgjedhjes duhet të përmbajnë efektivitetin në përfshirjen e grupeve të synuara dhe kërkesat e tyre në aspekt të kapacitetit administrativ dhe të shpenzimeve. Duke u mbështetur vetëm në dizajnin tarifor nuk është e mjaftueshme të sigurohet përballueshmëria: është i nevojshëm adaptimi i tarifave sociale dhe masave të ndihmës sociale, në pritje të ekzistimit të „infrastrukturës socio-politike“. Opsionet të cilat kanë të bëjnë me brengat për përballueshmëri do të kërkojnë finansim nga shfrytëzues tjerë të ujit ose nga tatim paguesit. Sistemet e finansuara nga shfrytëzuesit janë nën shtypje të madhe dhe në disa raste mund t'i arrijnë pritjet e tyre. Edhe çështjet e të drejtuarit me ujin në aspekt të opsioneve politike (për shembull: fragmentimi i sigurimit të shërbimeve në shumë zona) e kufizon fushën e subvencioneve të kryqëzuara në mesin e shfrytëzuesve.



Kapitulli 2

SI TË SHFRYTËZOHET KARTELA E VLERËSIMIT

SI TË ORGANIZOHET USHTRIMII PËR VETËVLERËSIM DHE PËR TRANSMETIM TË REZULTATEVE

Kjo pjesë ofron udhëzime strategjike, të bazuara në përvojën nga tre pilot ushtrimet (shihni kapitullin 3). Në realizimin e ushtrimeve për vetëvlerësim, vendet duhet t'i kenë parasysh qëllimet e tyre, pengesat dhe mundësitë. Udhëzimet nuk duhet të shihen si korniza strikte.

- 1. Qartëso qëllimet.** Ushtrimi për vetëvlerësim mund të ketë më shumë qëllime. Më shpesh, qëllimi primar do të jetë informimi dhe ndikimi në proceset politike ekzistuese ose që planifikohen në të ardhmen. Këto procese politike do të ndikojnë në kohën e ushtrimit për vetëvlerësim si dhe në rezultatet. Gjithashtu, duhet të identifikohen qëllime plotësuese, të cilat do ta formulojnë hartimin e ushtrimeve.

Shembujt e qëllimeve sekondare përfshijnë

- arritjen e të kuptuarit më mirë të situatës dhe sfidave;
- identifikimin e mangësive në informim dhe në politikat;
- ngritjen e ndërgjegjes në mesin e palëve të interesuara;
- identifikimin e palëve relevante të interesuara dhe krijimin e lidhjeve me ata;
- identifikimin e mundësive për koordinim më të mirë ndërmjet masave plotësuese politike qeveritare me mandat të përcaktuar.

- 2. Zgjidhni një udhëheqës të projektit.** Për shkak se vlerësimi i qasjes së barabartë në ujë dhe sanitacion prek shumë çështje, duhet të përfshihen shumë palë. Për shembull: ministri të ndryshme (e finansave, shëndetësisë, arsimit, ambientit jetësor, e punëve të brendshme, e drejtësisë dhe e politikës sociale), agjenci regullatore, autoritete lokale, dhënës dhe regullatorë të shërbimeve që kanë të bëjnë me ujin dhe sanitacionin, shoqata të qytetarëve të cilat punojnë me grupe të ndryshme të rrezikuara dhe organizata të shpenzuesve. Edhe pse nuk ekziston "udhëheqës i lindur" për ta udhëhequr implementimin e ushtrimit për vetëvlerësim dhe mandat i caktuar për projektin, do të nevojitet një udhëheqës. Preferohet, organizatë udhëheqëse për vetëvlerësim të jetë një agjenci qeveritare me mandat qartë të përcaktuar

3. Planifikoni kohën e nevojshme. Pilot ushtrimet janë zhvilluar për rreth gjashtë muaj, por një interval kohor më real do të ishte një vit. Ushtrimi duhet të përfshijë: zgjedhjen e një udhëheqësi të projektit dhe formimin e një "ekipi themelor" (muaji I), organizimin e një punëtorie fillestare (muajin e II), grumbullimin e të dhënave dhe plotësimin e kartelës së vlerësimit, kompletimin e raportit me konstatime paraprake (muaji VII), organizimin e një punëtorie për diskutimin e rezultateve (muaji VIII), dhe organizimin e një manifestimi politik ku do të prezantohen rezultatet nga ushtrimi për vetëvlerësim dhe të debatohet për shqyrtimin e arritjeve në procesin e politikave. (muaji XI)

Prandaj është e nevojshme të identifikohet koha e saktë për të cilën do të sigurohen të dhëna për procesin politik në të cilin ka për qëllim të ndikojë vetëvlerësimi. Koha është me rëndësi, meqë nëse procesi zgjat më shumë, ekziston rreziku i shkëputjes, largimit të palëve të interesuara.

4. Identifikoni partnerët e vërtetë dhe vendosini së bashku të balansuar në „ekipin themelor“. Edhe nëse organizata udhëheqëse është shumë kompetente, është e mundur ajo të mos ketë diversitet të gjërë në ekspertizën e nevojshme për kompletimin e vetëvlerësimit. Zgjedhja e anëtarëve "të ekipit themelor" në atë mënyrë bëhet hap kritik dhe ekziston mundësia për marrje kohe. Një ekip i balansuar themelor mund të arrihet në partneritet me organizata tjera të cilat kanë ekspertizë komplementare dhe kontakte (për shembull në fushën e çështjeve sociale) ose me kontraktimin e ekspertëve për përgatitjen e kapitujve të posaçëm për ushtrimin e vetëvlerësimit. Në çdo rast, është e këshillueshme për anëtarët e ekipit themelor që të zhvillojnë termat e referencës, duke përfshirë përgjegjësitë për të bërë analiza dhe rekomandime.

5. Siguroni përfshirje më të gjërë dhe të vazhdueshme të më shumë palëve të interesuara Tabela 1 jep shembuj të palëve të interesuara që duhet të përfshihen në ushtrimin për vetëvlerësim. Grupi i parë i palëve të interesuara është e përfaqësuar nga ministri të ndryshme të qeverisë dhe agjencione të cilat kanë ndikim në ecuritë për qasje të barabartë. Ata mund të shfrytëzojnë normalisht kanale formale për të plotësuar pjesët relevante në kartelën e vlerësimit; dhe kartela e vlerësimit është ashtu e dizajnuar që e mundëson këtë.

Një grup i ndryshëm i palëve të interesuara është e përfaqësuar nga organizatat e shoqërisë civile. Shpesh here nuk ekziston mekanizëm paraprak për mbledhjen e të dhënave nga organizata të cilat punojnë në çështjet sociale që kanë të dhëna të rëndësishme për të siguruar, por nuk mund të shohin dobinë e marrjes pjesë në ushtrimet e vetë vlerësimit. Kjo e bën të këshillueshme për të zhvilluar një qasje të strukturuar në angazhimin e tyre. Një opsion është të ketë si pjesë e "ekipit themelor" një agjencion ose organizatë e cila ka kontakte të mira mes shoqatave të qytetarëve, e cila mund ta marrë përsipër rolin udhëheqës në mbledhjen e kontributit të tyre.

Dhënësit e shërbimeve për ujë dhe sanitacion gjithashtu duhet të jenë të përfshirë në procesin dhe mund të kërkojnë konferencë dedikuar asaj se pse çështjet e qasjes së barabartë duhet të jenë relevante për ta.

TABELA 1. Shembuj të palëve të interesuara të cilat duhet të kyçen në ushtrimin për vetëvlerësim

MINISTRITË DHE AUTORITETE TJERA PUBLIKE	Ministria e shëndetësisë, Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, Ministria për politika sociale, Ministria për finansa, Ministria e ekonomisë, Ministria për punë të brendshme, Ministria për drejtësi, Ministria për arsim dhe shkencë, Ministria për vetëqeverisje lokale
SHOQATA QYTETARE	Shoqata të shpenzuesve, Shoqata të qytetarëve të cilat punojnë me grupe të rrezikuara dhe të marginalizuara (p.sh.grupe religjioze), fondacione, sindikata, akademikë dhe ekspertë të pavarur.
DHËNËS TË SHËRBIMEVE	Ndërmarrje të shërbimeve publike, Agjencioni për ushqim dhe veterinar, inspektoriati shtetëror sanitar dhe shëndetësor etj

6. Planifikoni me kujdes punëtorinë. Që të sigurohet përfshirja e hershme e palëve të ndryshme të interesuara, organizoni "punëtori fillestare" gjysmëditore duke e shpjeguar shënimin, qëllimet, procesin dhe rezultatet që priten nga ushtrimi për vetëvlerësim. Kjo punëtori mund të jetë e vlefshme në identifikimin e palëve shtesë të interesuara të cilët do të duhej të përfshihen në ushtrimin. Për shkak të arsyeve praktike, punëtorja gjysmëditore do të mund të pasohet menjëherë me një mbledhje pune gjysmëditore të ekipit themelor për vetë- vlerësim.

Është me rëndësi që pastaj të mbahet "punëtori për rezultatet" që të prezantohen rezultatet e përkohshme, të mblidhen informata plotësuese, të identifikohen opsionet për reforma dhe të diskutohen rekomandimet e mundshme. Një punëtori e tillë mund të mbahet gjatë dy ditëve (një ditë me një sesion paralel pune dedikuar pjesëve të ndryshme të kartelës së vlerësimit) që të sigurohet kohë e mjaftueshme për diskutime dhe të mundësohet që palët e interesuara të ndërhyjnë dobishëm. Mund të prezantohen tema të ndryshme nga ekspertët të cilët e kanë udhëhequr përpilimin e kapitujve ose pjesëve të ndryshme të dokumentit i cili diskutohet. Është me rëndësi që punëtorja të perceptohet si ngjarje teknike ku palët e interesuara mund të ndjehen të sigurtë kur i shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre.

7. Adaptoni përdorimin e kartelës së vlerësimit qëllimeve dhe nevojave të procesit. Kartela e vlerësimit është e dizajnuar për të siguruar një analizë gjithpërfshirëse. Disa nga pjesët e saj mundet të mos jenë relevante (p.sh. dallimet gjeografike kur territori i cili analizohet është një, dhe në masë të madhe mjedis homogjen urban), ose vendi ka identifikuar prioritetet të qarta në mesin e sfidave të shumta për qasje të barabartë në ujë dhe sanitacion. Në ato raste përdorimi i kartelës së vlerësimit mund të jetë kontraproduktiv, sepse do të kërkojë mbledhjen e informatave dhe diskutim për gjërat të cilat do ta tërheqin vëmendjen nga gjërat me interes primar.

Në rastet tjera, mund të jetë e përshtatshme të shtohen fusha të reja në kartelën e vlerësimit - p.sh. nëse gjendja e grupit të rrezikuar dhe të marginalizuar nuk është përshkruar mirë në cilën do fushë të përfshirë në pjesën 3 të kartelës së vlerësimit.

Më tutje, varësisht nga natyra e procesit, shpërndarja dhe prezantimi i rezultateve mund të sjellë deri te diskutime më tepër të dyshimta se sa ato të vlefshme. "Ekipi themelor" atëherë mund të mendojë t'i ruaj rezultatet për nevoja interne dhe t'i plotësojë diskutimet e palëve të interesuara me informatat e mbledhura. Si do që të jetë, në pjesën më të madhe të rasteve vetëvlerësimi i plotë i rezultateve do të jetë opsion më i përshtatshëm, sidomos për vetëvlerësimin fillestar.

8. Shfrytëzoni rezultatet nga kartela e vlerësimit për evaluim strategjik dhe dhënien e prioriteteve. Kartela e vlerësimit është mjet i dobishëm për zhvillimin e analizës gjithpërfshirëse të masave ekzistuese të politikës që të adresohen jo barazitë në qasjen në ujë dhe sanitacion. Ajo do të thotë se është sidomos e fuqishme si ndihmë në vënien e prioriteteve, në kushte të plotësimit të hendekut në informata dhe politika. Meqë është e nevojshme kohë e mjaftueshme që të përgjigjet, nuk preferohet si mjet vjetor për vëzhgim.

Kartela e vlerësimit nuk është e dizajnuar për të evaluar masat individuale të politikës, por evaluimi i masave ekzistuese të politikës do të ishte më se i nevojshëm që të përkrah vlerësimin me kartelën e vlerësimit. Një nga përfitimet nga përdorimi i kartelës së vlerësimit do të jetë identifikimi i masave të politikës dhe raportet për evaluimin, si dhe mangësitë gjatë evaluimit të masave të politikës. Rezultatet nga ushtrimi për vetëvlerësim mund të shfrytëzohen për krijimin e qëllimeve dhe datave për arritjen e qëllimeve në kuadër të protokollit për ujë dhe shëndet, si dhe për identifikim të asaj se cilat masa individuale do të duhej të prioritetizohen për tu vëzhguar dhe për ta evaluar përparimin.

Preferohet cikli i vetëvlerësimit ta përcjell atë të procesit politik i cili mundohet të ndikojë - p.sh. përgatitja e planit strategjik për sektorin e ujit dhe sanitacionit. Rezultatet nga vetëvlerësimi gjithashtu mund të ndikojnë në planet tjera strategjike, si ç'janë plani nacional për shëndet dhe mjedis jetësor, strategjia për përfshirje sociale, plani regional për zhvillim, ose plane nacionale për shkolla ose burje.

9. Prezantoni rezultatet në mënyrë atraktive. Kartela e vlerësimit është mjet themelor për mbledhjen, organizimin dhe evaluimin e informatave ekzistuese. Ajo përfshin "rezime" për lehtësimin e komunikimit të rezultateve. Rezimeja është e dobishme për identifikimin e agregimit në nivele të larta, fushat e aksioneve të cilat vonohen. Megjithatë, kartela e vlerësimit nuk është mjet i mirë komunikativ për ta përfshirë publikun jo të specializuar.

Prandaj preferohet të përgatitet analize e situatës prej 10 faqesh e cila do t'i përmbledhë rezultatet kryesore nga kartela e vlerësimit, të sigurojë shembuj për përparimet, të identifikojë fusha prioritare për aksion të shpejtë dhe të propozojë rekomandime specifike.

Një rezime tjetër edhe më e shkurtër për politikën, prej më pak se katër faqesh do të ishte komunikim i dobishëm në arritjen e rezultateve të autoriteteve zyrtare dhe për komunikimin e rezultateve në publik përmes medimeve publike. Do të nevojitet të sigurohet buxhet i posaçëm për zhvillim dhe përgatitje të këtyre prodhimeve për komunikim.

10. Shfrytëzoni rezultatet për vëzhgimin e përparimit, jo për krahasim me të tjerët. Mjeti është krijuar që t'i ndihmojë vendit (ose regjionit) t'a vëzhgojë përparimin e vet drejt qasjes së barabartë. Mjeti nuk është dizajnuar që të bëjë krahasim mes vendeve (ose regjionit), sepse regjioni pan – European përfshin vende (ose regjione) me nivele të ndryshme të zhvillimit socio – ekonomik dhe organizim të sektorit për ujë dhe sanitacion.

Analistët të cilët duan të bëjnë krahasime, inkurajohen t'i shfrytëzojnë të dhënat në kontekstin e ofruar nga profile të vendit ose regjionit me qëllim që t'i identifikojnë vendet/regjionet e përshtatshme për krahasim. Realizimit të këtyre krahasimeve, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë, sepse definicionet e statistikës mund të dallohen dukshëm dhe rezultatet do të mund të ishin shumë subjektive.

UDHËZIME PRAKTIKE – SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E KARTELËS SË VLERËSIMIT

Informata kryesore. Informatat kryesore në lidhje me çështjen e qasjes së barabartë mund të gjenden në publikimin e UNECE - OBSH/Europa «Askush nuk është lënë pas». Hyrja në secilën pjesë të kartelës së vlerësimit tregon për kapitullin gjegjës në publikimin « Askush nuk është lënë pas », e cila i dedikohet çdo fushe të veprimit.

Fjalor. Një fjalor i shkurtër i definon konceptet kryesore të cilat përdoren në kartelën e vlerësimit. Vlen të theksohen dy çështje:

Në këtë dokument, shprehja «qasja në ujë dhe sanitacion» përbëhet nga pesë dimensione të cilat e definojnë të drejtën e njeriut për ujë dhe sanitacion: disponueshmërinë, qasjen, cilësi / sigurinë dhe përballueshmërinë. Disponueshmëria është përfshirë në mënyrë speciale në fushën 4 të kartelës së vlerësimit.

Ky dokument i përket shprehjes «qasje e barabartë në ujë dhe sanitacion», që është tekst nga Protokoli për ujë dhe shëndet. Disa ekspertë e favorizojnë shprehjen «barabarësi dhe jodiskriminim». Edhe pse ekzistojnë disa dallime në konotacion, këto dy shprehje mund të konsiderohen si ekuivalente në aspekt praktik.

Struktura e mjetit. Mjeti përfshin profil të shkurtë të vendit (që fokusohet në të dhënat kuantitative që të ndihmojë rezultatet të vihen në kontekst), si dhe katër pjesë të cilat i dedikohen temave të gjëra. Katër pjesët tematike më tutje janë të ndara në fusha të aksionit, të cilat fokusohen në masat që merren për përmirësimin e qasjes së barabartë.

Informata kuantitative. Nëse është e mundshme, burim i informatave kuantitative duhet të jetë statistika zyrtare. Kur sigurohen informata në lidhje me resurset financiare, shënoni valutën..

Metodologjia e vlerësimit me poena.

- Përparimi në çdo fushë të veprimit, matet me pyetjet kuantitative. Numri i pyetjeve ndryshon mes 2 dhe 6.
- Çdo pyetje kërkon një përgjigje. (Ekzistojnë katër përgjigje të mundshme. Jo / Deri në shkallë të caktuar / Në masë të madhe / Po). Tabela më poshtë jep drejtime për atë se si duhet të interpretohet secila përgjigje e mundshme. Të anketuarit janë të inkurajuar t'i ndajnë përgjigjet në katër rezultate të mundshme që t'i iket grumbullimit të të gjitha përgjigjeve në kategorinë «deri në shkallë të caktuar» dhe në «në masë të madhe».
- Çdo përgjigje patjetër duhet të jetë e arsyetuar. Që të arrihet kjo, të anketuarit mund të përdorin informata kuantitative ose kualitative nga dokumente juridike, dokumente këshillë dhënëse, raporte analitike, anketa ose burime të ngjajshme. Të anketuarit inkurajohen të shfrytëzojnë aq hapësirë sa u nevojitet.
- Besueshmëria e secilës përgjigje duhet të vetëvlerësohet (shih më poshtë).
- Një rezultat i rezimuar duhet të kalkulohet për secilën fushë të veprimit. Ky rezultat duhet të kalkulohet duke marrë parasysh poenat për secilën pyetje, si dhe numrin e pyetjeve në kuadër të secilës fushë të veprimit. Vetëm përgjigjet me shkallë të mesme dhe të lartë të sigurisë duhet të merren parasysh gjatë kalkulimit të rezultatit të përgjithshëm.
- Rezultati përfundimtar duhet të riprodhohet në bilancin përmbledhës.

NOTIM	INTERPRETIM
JO	Nuk ka ose ka shumë pak dëshmi mbështetëse një përgjigje pozitive që është në dispozicion, qoftë në nivel kombëtar apo lokal. .
DERI NË MASË TË KAKTUAR	Ka disa informata të kufizuara në nivel lokal për mbështetje të përgjigjes pozitive. Ekzistojnë disa informata të kufizuara në nivel nacional me mbështetje të pjesërishtme të përgjigjes pozitive.
NË MASË TË MADHE	Ekzistojnë informata të shumta në nivel lokal, dhe disa në nivel nacional për mbështetje të përgjigjes pozitive.
PO	Ka dëshmi të mjaftueshme të disponueshme në nivel nacional, të cilat plotësisht e mbështesin përgjigjen pozitive.

SQARIM: Termi «informata» dhe «dëshmi» në këtë tabelë duhet të interpretohet si informatë relevante kualitative ose kuantitative për mbështetjen e përgjigjes në pyetjen.

Metodologjia për vlerësimin e sigurisë. Të anketuarit duhet vetëm të vlerësojnë sa është e sigurtë çdonjëra nga përgjigjet në krahasim me procesin e mbledhjes dhe transmetimit të të dhënave, e jo vetë të dhënat.

- Tri nivele të sigurisë: i lartë (shumë i sigurtë), i mesëm (i sigurtë), i ulët (jo i sigurtë).
- Kriteret për përcaktimin e shkallës së sigurisë: procedura, vëzhgimi dhe vlerësimi.
- Në tabelën më poshtë janë dhënë orientime për atë se si të ndahet niveli i sigurisë, sipas këtyre kriterëve:
 - I lartë – nëse të gjitha përgjigjet në fushën e aksionit janë klasifikuar si të larta;
 - I mesëm – nëse nuk ka përgjigje të klasifikuar si i ulët, ndërsa së paku një përgjigje klasifikohet si i mesëm;
 - I ulët – Nëse vetm një përgjigje është klasifikuar si i ulët.
